



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komuna e Gjakovës

Nr. 01-112/02-1628

Data: 05.02.2024

Vendi: Gjakovë

Në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 05.02.2024, Komuna e Gjakovës nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Miratohet plani i integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr.01-112/02-26240, datë 16.11.2023, zyrtari i lartë ligjor z. Taulant Vokshi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 05.02.2024, Komuna e Gjakovës nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim Nr.01-112/02-26240, datë 16.11.2023, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të Vendimit.

Sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi, z. Taulant Vokshi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Personit përgjegjës;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Kryetari i Komunës së Gjakovës


Ardian Gjini

